



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA MALLAKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2978/ prot.

Ballsh, më 21.06.2024

PROCESVERBAL

I dëgjësës publike për fazën e parë të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

I mbajtur më datë 21.06.2024, në Fratar me banorë të Njësive Administrative: Fratar, Kutë dhe Selitë.

Kryetari i këshillit, Z. Nexhmi Sulaj hap këtë dëgjësë publike: Faleminderit që keni ardhur sot këtu për të dëgjuar prezantimin që do bëjmë për fazën e parë të P.B.A 2025-2027, pas prezantimit, do dëgjojmë dhe kërkesat dhe sygjerimet tuaja, që t'i reflektojmë në projektaktin e programit buxhetor afatmesëm.

Kryetari i bashkisë, Z. Qerim Ismailaj: Sipas ligjit duhet kryer dëgjesat publike për prezantimin e buxhetit, kjo është thjesht faza e parë, por edhe nëse harrojmë diçka sot në prezantim, kemi kohë t'i rikuperojmë në dy fazat e tjera. Çdo buxhet funksionon në bazë të një parashikimi, projekt buxheti afatmesëm ka një periudhë tri vjeçare. Pra, nënkupton hartimin e strategjive sipas politikave të bashkive.

Në P.B.A 2025-2027 janë përfshirë:

- Rikonstruksione rrugësh;
- Investime për linja ujësjellësash;
- Për bujqësinë;
- Një vlerë e konsiderueshme për përkrahje të personave që trajtohen me ndihmë ekonomike, etj.

Pra, të gjithz zërat që bëjnë pjesë brenda një buxheti. Sipas mundësive tona, kemi parashikuar rikonstruksione rrugësh nëpër fshatra, po pse jo edhe nëpër lagje. Me qënë se jemi këtu, po përmendim edhe ndërhyrjen që është parashikuar për t'i bërë rrugës këtu në Fratar, për të kaluar

pastaj në segmentet rrugore të Kremenarit dhe Gadurovës, që janë pjesë e Njësisë Administrative Fratar.

Gjithashtu kemi një marrveshje me Bashkinë Memaliaj për rrugën në Ninësh-Hallkomemaj.

Aktualisht, për sa i përket zonës tuaj, kemi në prokurim projektin e ndërtimit të shkollës Gjak Doçi, që në të ardhmen të jetë një shkollë qendër edhe për nxënësit e Kutës dhe Selitës, me qënë se numri i nxënësve është çdo ditë në rënie.

Jemi duke diskutuar projektin për emergjencat civile: Rehabilitimi i Digës së Gadurovës. Dikush nga ju mund të thotë, na shtroni rrugët pastaj digën, por këto janë të ardhura nga fondi për digat sipas projekteve fituese..

Po bëjmë plane për rikonstrukcion rrugësh në Njësinë Administrative Selitë, e tillë si rruga Gjerbës Çerril.

Shpresojmë të rregullojmë dhe zgjidhim furnizimin me ujë të pijshëm në lagjen Sulaj, pse jo dhe këtu në Fratar, edhe pse ujësjellës kanalizime kanë kaluar si asete të A.K.U.K-së dhe nuk janë më pjesë të bashkive.

Drejtori ekonomik Z. Aleksandër Rama: Kemi parashikuar shtrirjen e taksapaguesëve, pra atje ku ofrohet shërbimi të vilen dhe taksat. Bëj thirrje që banorët ti paguajnë taksat në kohë, që dhe bashkia të realizoj këto investime të parashikuara.

Znj. Miranda Osmënaj: 1.A paguan bashkia punëtor për mirëmbajtjen e rrugëve që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin, atëherë këto rrugë pse nuk pastrohen? 2. U bë çatia e shkollës, pasi u dogj, dhe ka ngelur një pjesë e vogël te ballkoni për disa ristela, na u kërkua neve mësuesëve të kontribuonim me një vlerë të vogël, pse keq për aq lekë është bashkia? Faleminderit!

Z. Qerim Ismailaj: E vlerësoj shqetësimin për rrugën, sepse po çdo punonjës duhet të bëj punën atje ku është, do interesohemi. Për sa i përket shkollës, ishte një fond i miratuar në situatë emergjente, më qënë se çatia u dogj, e cila u realizua me një fond prej 26 milion lekësh të vjetra, një çati me ato përmasa, kam qënë dhe vet në terren dhe firma nuk ka më asnjë detyrim, aq vlerë fondi sa pati e realizoj. Bashkia nuk është keq për aq pak lekë sa mund të duhen për ato ristela, por nuk mund të hedhim fond mbi fond, qoftë edhe për 10 mijë lekë të vjetera, se na kapet shkelje, por më gjeni dikë që ti bëj ato ristela dhe jam i gatshëm ta paguaj unë. Vlera që ju është kërkuar mund të ketë qënë një iniciativë e dikujt për të realizuar diçka të mirë. Por di të them që çdo fillim viti shkollor, prej të paktën 4-5 vjet, ne ndërhyjmë në mirëmbajtje të ambjentëve shkollorë, se më përpara ju kërkohet lekë nxënësve për të bër lyerje dhe gjëra të tjera, këtë e them nga eksperiencia me fëmijët e mi. ndërhyrja në këtë shkollë do të jetë e reduktuar sepse është gati projekti për shkollën e re.

Z. Përparim Ramaj, ka kërkuar rrugën Ramaj-Ninësh, - ju faleminderit që na respektoni në kërkesat tona dhe suksese në punët në vazhdimësi!

Z. Xhesmi Sulaj: kam një shqetësim në lidhje me shkarkim e mbeturinave këtu nga dikush me makinë private me karroceri, a nuk ka kosha në çdo lagje?

Z. Qerim Ismailaj: për sa përket pastrimit, do thoja që ka pasur një ndryshim thuajse rrënjësor edhe pse më një përpjeke shumë të madhe, por patjetër që do merremi me këtë shqetësim, do mbledhim informacion dhe do merren masa.

Z. Musa Kapllanaj: Mos harroni pjesën e transportit për organizimin e veteranëve për në Skrapar më datë 23.

Znj. Armela Malaj: Pjesa e transportit është e siguruar për çdo datë historike ku marrin pjesë veteranët.

Z. Nexhmi Sulaj: Këni ndonjë shqetësim ose sygjërim tjetër, nëse jo e mbyllim këtu këtë prezantim. Shumë faleminderit të gjithëve!

MBAJTËS TE PROCESVERBALI

KOORDINATORI PËR NJOFTIMIN DHE

KOSULTIMIN ME PUBLIKIKUN

Rovena Osmënaj



SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

Zinaida Ahmetaj

